




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot
Dep. <u>2-D/DPK1</u>	Br Prot <u>01-1978/2012</u>
Nr. i faq.	Prot No
Broj stranica <u>02</u>	Date <u>29-05-2012</u>
Nr. pages	Datum



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **28.05.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-1318/12, pa konflikt interesi për z. Behxhet Pacolli – Zavendës Kryeministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës, **për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti nr. AKK-03-1318/12, i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, z. Behxhet Pacolli–Zv.Kryeministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas denoncimit të rastit (Neni 18, pika 2, Ligji Nr.04/L-051), për të cilin është dyshuar se ka pas situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me rastin e nënshkrimit të një Memorandumi Mirëkuptimi në mes të Qeverisë së Kosovës dhe një Konzorciumi firmash ndërkombëtare; zyrtarit të lartë, ztr. Behxhet Pacolli, me funksion të lartë publik si Zavendës Kryeministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës, i ishte bërë shkresa e parë njoftuese.

Agjencia kundër Korrupsionit lidhur me këtë rast ka siguruar dokumente të nevojshme për të nxjerr vendimin e vet për këtë situatë.

Dokumentet e kërkuara, i janë ofruar Agjencisë kundër Korrupsionit e ndër to edhe një letër përcjellëse e shkruar nga vet Zavendës Kryeministri Pacolli, në të cilën ai ka deklaruar se nuk ka asnië interes të tii privat që lidhet me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit.

Pas analizës së dokumenteve të ofruara, është konstatuar se në Memorandumet e nënshkruara në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Zvendës Kryeministri Pacolli, dhe Konzorciumit të Firmave Oceanmar Services Ltd e Seagas International Ltd, me Qeverinë e Nigerisë, nuk ka asnjë lloj papajtushmërie të funksioneve.

Sipas dokumenteve që Agjencia kundër Korrupsionit i ka siguruar, në të gjitha këto raporte, ztr. Behxhet Pacolli ka përfaqësuar Republikën e Kosovës dhe në asnjë nga këto prova, nuk shihet se ztr. Pacolli është përfaqësues i firmave private ndërkombetare.

Në informacionet zyrtare mbi bizneset e përmendura, shihet se ztr. Behxhet Pacolli, në to nuk ka as pjesë të pronësisë, e as nuk ushtron asnjë funksion menaxhues në to.

Kështu, në bazë të këtyre informacioneve zyrtare, kemi konstatuar se nuk ka pas situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

